



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Bazuar në nenin 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 Për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve, Organi Shqyrtues i Prokurimit bën :

Shpallje të Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit :	Organi Shqyrtues i Prokurimit
Divizioni :	Divizioni i Brendshëm
Titulli i vendit të punës :	Përkthyes/e i/e Gjuhës Serbe (1 vend pune)
Numri i referencës :	OSHP-2-2018/MSHV
Paga mujore :	464 Euro (Bruto)
Raporton te :	Udhëheqësja e Divizionit të Brendshëm
Lloji i kontratës :	“Marrëveshje për Shërbime të Veçanta” - (MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës :	Tre (3) deri në gjashtë (6) muaj
Orari i punës :	I plotë, 40 orë në javë
Data e Shpalljes :	11.10.2018
Lokacioni :	Prishtinë ish-Ndërtesa e Bankes së Lublanes, Kati i -V-të

Detyrat dhe përgjegjësitë:

1. Bën përkthimin e të gjitha dokumenteve të OSHP-së, qe kërkohen nga gjuha Shqipe në gjuhën Serbe dhe anasjelltas;
2. Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës me Udhëheqësin/en i/e Divizionit të Brendshëm, stafin tjetër profesional për zbatimin e detyrave, shërbimeve dhe produkteve përkatëse të përkthimit;

3. Kryen detyra të kërkuara në fushën profesionale specifike të përkthimit, duke përfshirë kryerjen e përkthimeve direkte, përkthimin e ankesave, ekspertizave, vendimeve të OSHP-së, përkthimin e dokumenteve të përzgjedhura hyrëse dhe dalëse etj;
4. Mirëmbajtjen e sistemit personal të aktivitetit të materialeve të përkthyera në mënyrë korrekte dhe konfidenciale;
5. Kryen detyrat në fushën profesionale specifike të përkthimit nën mbikëqyerjen e përgjithshme;
6. Komunikon brenda OSHP-së, për shkëmbim të informatave në fushën e interesit të përbashkët;
7. Ofron përkrahje në fushën specifike profesionale të përkthimit për stafin e nivelit më të lartë profesional sipas kërkesës;
8. Kryen detyra tjera në fushën profesionale specifike të përkthimit në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe.
9. Kryen edhe detyra tjera të cilat mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe nga mbikëqyrësi;
10. Përkthyesja Shqip – Serbisht dhe anasjelltas, raporton të Udhëheqësja e Divizionit të Brendshëm.

Kualifikimi, Aftësitë / përvoja dhe atributet e tjera që kërkojnë:

- Diplomë universitare, ose ndonjë certifikatë që posedon për përkthime dhe njohjen e gjuhës serbe;
- Njohja e punës me kompjuter në programet Word , Excel, përdorimin e Internetit dhe Data bazës;
- Dy vite përvojë pune.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë shkollimin e kërkuar aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Data e mbylljes së konkursit : 17.10.2018

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet mund t'i merrni dhe t'i dorëzoni në Organin Shqyrtues të Prokurimit në **Zyrën e Personelit**, Rruga "Migjeni" ish-Ndërtesa e Bankës së Lublanes, Kati i-V-të.

Për informata të hollësishme mund të kontaktoni Zyrën e Personelit në numrin e Tel. **038/212-360**, prej orës 08:00 – 16:00, apo të shkruani në e-mail: arta.S.berisha@rks-gov.net.

Aplikacionit duhet t'i bashkangjiten : Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit, si dhe dokumentacionet tjera të nevojshme sipas konkursit.

Afati i konkursit është e hapur 7 ditë nga data e publikimit në web – faqen zyrtare të Organit Shqyrtues të Prokurimit www.oshp@rks-gov.net, duke filluar nga data **11.10.2018** e deri më datën : **17.10.2018**, që konsiderohet si ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës të mbylljes së konkursit nuk do të pranohen, si dhe ato të pakompletuara do të refuzohen.